



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS BËRTHAMË TË GJIMNAZIT

FUSHA: GJUHË E HUAJ

LËNDA: GJUHË ANGLEZE

KODI: 3.1.11.B

PROGRAMI I LËNDËS GJUHË ANGLEZE

PËR KLASËN E 11^{të}

TIRANË, DHJETOR 2009

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11^{të} është një dokument zyrtar dhe ka për qëllim të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, të mësimnxënies dhe të vlerësimit të nxënësit, në nivelin gjuhësor B1.2, sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER), duke mundësuar që nxënësi nga përdorues i nivelit prag të gjuhës (B1+ në klasën e X-të), të bëhet përdorues prag, i pavarur.

Ky program mbështetet edhe te udhëzimet e Kurrikulës Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar. Programi i klasës 11^{të} mishëron të gjitha njohuritë gjuhësore, ndërlëndore dhe ndërkulturore të përfuara nga klasa e 3^{të} deri në klasën e 10^{të}.

Programi mundëson realizimin e nevojave dhe interesave gjuhësore e kulturore të nxënësve, duke i ndërthurur ato me përvojat dhe dijet mbi botën që e rrethon. Kështu, programi kërkon që nxënës/i,-ja të rrisë e të thellojë aftësitë e tij shprehëse në gjuhën angleze, drejt thellimit të procesit të formimit të tij si përdorues i pavarur.

Programi mbështetet në interesat dhe nevojat gjuhësore të grupmoshës dhe nxit zhvillimin e pavarur, intelektual dhe socialkulturor të nxënësve.

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11^{të} e drejton nxënës/in,-en të mësojë në mënyrë të pavarur, të zhvillojë të menduarit kritik dhe e përgatit për të nxënit gjatë gjithë jetës. Këto mënyra të mësimdhënies/nxënies realizohen me sukses duke ndërthurur forma të ndryshme të punës individuale dhe të asaj në grup.

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11^{të}, si pjesë përbërëse e kurrikulës së re të AML-së, lidhet edhe me programet ndërkurrikulare të kësaj klase, duke rritur dhe forcuar njohuritë e nxënës/it,-et jo vetëm në gjuhën angleze, por edhe në lëndët e tjera, si p.sh.: në histori, gjeografi, biologji, matematikë, informatikë etj., duke i ndërthurur këto dije në mënyrë logjike dhe krijuese. Kjo ndërthurje ndërlëndore bëhet në mënyrë të vetëdijshme. Gjatë procesit të mësimdhënies/nxënies në klasën e 11^{të}, nxënës/i,-ja përfiton dije të qëndrueshme dhe të vazhdueshme me përdorimin e formave të larmishme të punës së tij/saj dhe ndihmën e mësuesit. Këto dije e përgatisin nxënës/in,-en të përballet me studime të mëtejshme, si dhe me mundësinë për punësimin brenda ose jashtë vendit.

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11^{të} është konceptuar dhe hartuar në mënyrë të tillë që nxënësi, me dijet e marra gjatë procesit mësimor, të zhvillojë personalitetin e tij/saj, duke rritur besimin dhe ndjenjën e përgjegjësisë ndaj vetes dhe shoqërisë.

1. SYNIMI I LËNDËS

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11^{të} është një shkallë më e lartë se niveli prag dhe synon të pasurojë aftësitë e fituara në nivelet e mëparshme, në mënyrë që nxënës/i,-ja të arrijë të konsolidojë nivelin B1+ dhe të kalojë në atë B1.2, ku nxënës/i,-ja nga përdorues i nivelit prag të gjuhës (B1+ në klasën e X-të), bëhet përdorues prag i pavarur.

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11^{të} synon që nxënës/i,-ja:

- të thellojë njohuritë gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse;
- të thellojë më tej aftësitë komunikuese duke përdorur njohuritë gjuhësore në rrethana të jetës së përditshme;
- të reagojë në mënyrë të përshtatshme në rrethanat e komunikimit ndërkulturor;

- të forcojë më tej ndërveprimin në situata reale jashtëshkollore;
- të përforcojë bashkëveprimin e punës në grup me punën e pavarur individuale dhe krijuese;
- të ushtrohet në punë të pavarur dhe krijuese brenda dhe jashtë klasës.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11^{te} ka si objektiv të përgjithshëm të zhvillojë aftësinë analitike të një informacioni më të gjerë gjuhësor dhe kulturor, duke e ndërthurur këtë informacion me njohuritë e lëndëve të tjera, ku nxënësi zhvillon më tej:

- shprehinë me shkrim dhe me gojë;
- saktësinë me shkrim dhe me gojë;
- aftësinë për të përballuar me shkathtësi problemet e përditshme përmes formimit të tij/saj gjuhësor;
- aftësinë për të vënë në dukje dallimet ndërmjet kulturave të ndryshme.

3. OBJEKTIVA

a) Objektiva sipas standardit në komunikim

Përshkrimi. Objektivat e standardeve në këtë fushë i japin më shumë rëndësi analizës gjuhësore dhe thellojnë ndërveprimin gjuhësor për të realizuar më mirë komunikimin në gjuhën angleze. Programi i klasës së 11^{te} vendos një standard më të lartë gjuhësor në mënyrë që nxënës/i,-ja të përballojë situata të ndryshme të komunikimit të përditshëm, në një mjedis gjuhësor e kulturor anglistfolës, ku sasia e informacionit që shkëmbehet është më e madhe dhe e një shkalle më të lartë vështirësie.

	Objektiva
Komunikimi	<p>Në përfundim të klasës së 11 nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të përshkruajë; ▪ të parashikojë; ▪ të identifikojë, të interpretojë, të këmbëjë dhe të miratojë informacionin / mesazhin; ▪ të ndjekë, të kuptojë thelbin dhe detajet e bisedës. ▪ të sqarojë; ▪ të përcjellë informacion; ▪ të shprehë pikëpamjet; ▪ të krahasojë; ▪ të shpjegojë; ▪ të bëjë dallimin; ▪ të klasifikojë; ▪ të shprehë ndërvarjen e veprimeve, të

		<p>fakteve, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të diskutojë; ▪ të debatojë; ▪ të përsërisë; ▪ të ndërveprojë; ▪ të shkruajë; ▪ të hartojë; ▪ të përmbledhë; ▪ të analizojë; ▪ të bëjë kërkime; ▪ të negociojë; ▪ të intervistojë; ▪ të nxjerrë përfundime <p>në situata të ndryshme, si p.sh.: jeta e përditshme, jeta në shkollë, bota përreth nesh, bota e komunikimit, jeta personale dhe shoqërore, etj.</p>
Veprimtaritë komunikimit	e	<p>Në përfundim të klasës së 11 nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të miratojë dhe të korrigjojë; ▪ të kundërshtojë dhe të përforcojë; ▪ të kërkojë dhe të japë leje; • të formulojë një ankesë; ▪ të urojë; ▪ të bëjë hipoteza; ▪ të shprehë keqardhje dhe dëshira; ▪ të falë dhe të kërkojë falje; ▪ të nxisë; ▪ të shprehë pëlqime dhe mospëlqime; ▪ të verifikojë <p>për përvoja të ndryshme, në situata të jetës së përditshme, si: festa, takime, ditëlindje, treg, vende të panjohura, shkollë, mbrëmje, ekskursione, diskutime rreth aktualitetit, interesat etj.</p>

b) Objektiva sipas standardit në kulturë

Përshkrimi. Objektivat e standardeve në këtë fushë thellojnë njohuritë kulturore dhe të sjelljes gjuhësore të nxënësit duke dalluar elementet kulturore të gjuhës që ai/ajo mëson si dhe duke vendosur marrëdhënie me kulturën e gjuhës amtare.

	Objektivat
Kultura	<p>Në përfundim të klasës së 11 nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vendosë marrëdhënie ndërmjet kulturës amtare dhe kulturës së huaj, duke përcaktuar dhe zbatuar

	<p>strategji të ndryshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të zotërojë njohuri të karakterit të përgjithshëm për të dhënat gjeografike, ekonomike e politike të vendeve kryesore anglishtfolëse; • të përdorë sipas regjistrave të ndryshëm të gjuhës (zyrtare, miqësore, konfidenciale, normale, informale etj.) rregullat e mirësjelljes të popullit, gjuhën e të cilit mëson, (përdorim i përshkallëzuar i urimeve, përshëndetjeve, formave të adresës, fjalëve të urta etj.); • të kërkojë fjalën në publik, si dhe të përdorë si duhet gjestet, pozicionin që shoqërojnë ligjërimin; • të kërkojë fjalën në publik, duke përdorur gjeste, dhe duke mbajtur pozicion të pështatshëm për ligjërimin; • të shmangë format urdhërore, duke i zbutur ato me kushtoren kur shpreh një kërkesë; të dijë si të përdorë pasthirrmat etj.; • të komentojë rreth monumenteve të artit, personaliteteve, ngjarjeve të rëndësishme të historisë dhe të aktualitetit; • të shprehet qartë për shijet e të rinjve, tregun, çmimet, modën etj.; • të analizojë një film, dramë, koncert apo vepër letrare, duke bërë komente mbi to (të shprehë admirim, pëlqim, mospëlqim, shije të tjera);.
--	--

c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor

Përshkrimi. Objektivat e standardit në këtë fushë e aftësojnë nxënës/in,-en të prodhojë elemente gjuhësore që i përkasin nivelit B1.2, ku nëpërmjet situatave të ndryshme ligjërimore, nxënës/i,-ja nxitet të praktikojë struktura gramatikore të gjuhës angleze, si dhe të kuptojë lidhjen dhe përdorimin e saktë të tyre. Këtu vihet theksi në analizën e njohurive gramatikore të përfuara në nivelet e mëparshme gjuhësore, duke tentuar në përdorimin e tyre dhe të strukturave të reja gjuhësore, në situata më të ndërlikuara drejt një shkalle më të lartë saktësie.

	Objektiva
Elemente gramatikore	<p>Në përfundim të klasës së 11 nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të analizojë; ▪ të bëjë sintezë; ▪ të argumentojë; ▪ të riprodhojë në mënyrë krijuese;

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të bëjë hipoteza; ▪ të përdorë në mënyrë krijuese foljen në kohë dhe kombinime të ndryshme, formën veprorë dhe pësore të foljes në struktura të ndërlikuara, foljet kalimtare e jokalimtare, struktura komplekse të ligjëratës së drejtë dhe të zhdrejte, fjalitë e përbëra (kushtore, dëshirore, kohore), dallimet kuptimore në përdorimin e formave të pashtjelluara, lidhëzat, format e ndërlikuara të foljeve frazale e modale, përemrat vetvetorë, përemrat e pacaktuar, rendin e fjalëve në fjali, mbiemrat dhe format e tyre më të ndërlikuara, ndajfoljet dhe nyjat, emrat e përbërë, parashtesat dhe prapashtesat nëpërmjet situatave të ndryshme nga jeta e përditshme.
--	--

4. OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektivat
Të dëgjuarit	<p>Në përfundim të klasës së 11 nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të ndjekë një ligjëratë ose parashtrim mbi tema të interesit personal ku tema të jetë e njohur dhe paraqitja e drejtpërdrejtë, e thjeshtë dhe e ndërtuar qartë; • të ndjekë thelbësoren e një ligjërimi që është i ndërlikuar nga pikëpamja e formës dhe e përmbatjes; • të kuptojë me pak sforcim një pjesë të madhe të asaj që është thënë në praninë e tij nga folës vendas, por mund të ketë pak vështirësi për të marrë pjesë në diskutim; • të kuptojë idetë kryesore të ndërhyrjeve të ndërlikuara nga pikëpamja e brendisë dhe të formës mbi një temë konkrete ose abstrakte dhe në një gjuhë standarde; • të kuptojë një informacion faktik, të drejtpërdrejtë mbi tema të jetës së përditshme, si në lidhje me shkollën, kohën e lirë, duke kapur mesazhin e përgjithshëm dhe hollësitë, me kusht që shqiptimi të jetë i qartë; • të kuptojë shumicën e emisioneve të lajmeve dhe revistave televizive, tema e të cilave është e interesit personal, gjuha standarde dhe e artikuluar qartë; • të kuptojë shumicën e dokumentarëve në radio, në gjuhë standarde dhe të identifikojë në mënyrë të saktë humorin, tonin e folësit;

	<ul style="list-style-type: none"> • të kuptojë lajmërimet dhe mesazhet të përditshme mbi tema konkrete e abstrakte; • të ndjekë thelbësoren e asaj që thuhet mbi tema të përgjithshme, me kusht që bashkëfolësit të evitojnë përdorimin e shprehjeve idiomatike, dhe të kërkojnë sipas rastit që t'i bëhen përsëritje ose sqarime.
Të lexuarit	<p>Në përfundim të klasës së 11 nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kuptojë në një nivel të kënaqshëm tekste faktike, të drejtpërdrejta mbi tema të fushës dhe interesave të tij; • të identifikojë fjalë dhe shprehje të panjohura me ndihmën e kontekstit mbi tema që kanë lidhje me interesat e tij; • të gjejë dhe të kuptojë informacionin e duhur në shkrimet e përditshme, sic janë letrat dhe dokumente të shkurtra zyrtare; • të përshkojë një tekst relativisht të gjatë, për të gjetur informacionin që kërkon dhe të mbledhë informacione nga pjesë të ndryshme të tekstit ose teksteve të ndryshme, për të përmbushur një detyrë specifike; • të dallojë përfundimet kryesore të një teksti argumentues të ndërtuar qartë; • të kuptojë artikujt e specializuar jashtë fushës së tij, me kusht që t'i referohet herë pas here fjalorit për të verifikuar kuptimin; • të identifikojë përmbajtjen dhe përshtatshmërinë e një informacioni, të një artikulli apo të një reportazhi me një gamë të gjerë temash; • të kuptojë përshkrimin e ngjarjeve, ndjenjave, dëshirave në mënyrë të mjaftueshme për të mbajtur një korrespondencë të rregullt me një mik; • të kuptojë mënyrën e përdorimit të një aparati, nëse ai është i drejtpërdrejtë, jo i ndërlikuar dhe i hartuar qartë.
Të folurit	<p>Në përfundim të klasës së 11 nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të komunikojë me njëfarë sigurie mbi tema të njohura të zakonshme ose që nuk janë të lidhura me interesat e tij; • të shkëmbejë, të verifikojë e të konfirmojë informacione, të përballojë situata jo të zakonshme dhe të shpjegojë përse ka vështirësi; • të shpjegojë se përse diçka përbën problem, të diskutojë mbi vazhdimin, të krahasojë e të përballë zgjidhjet; • të komentojë shkurt pikëpamjen e dikujt; • të vërë në dukje domethënien personale të fakteve dhe përvojave, të shprehë opinione dhe t'i mbrojë ato duke i dhënë shpjegime dhe argumente; • të zhvillojë një argumentim pa vështirësi duke qenë i

	<p>kuptueshëm në të shumtën e kohës;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të reagojë ndaj ndjenjave të tilla, si: habia, gëzimi, trishtimi dhe t'i shprehë ato; • të transmetojë në shkallë të ndryshme emocionet dhe të theksojë atë që është më e rëndësishme për të në një ngjarje apo përvojë; • të shprehë qartë një pikëpamje, nëse ka vështirësi, të angazhohet në një debat me folës vendas; • të formulojë një ankesë, të parashtojë arsyet për të përfutur një zhdëmtim (duke kërkuar të kthejë një objekt të blerë me defekt); • të bëjë përmbledhjen e informacioneve dhe argumenteve të dala nga burime të ndryshme në vija të trasha; • të japë shkurtimisht arsye dhe shpjegime në lidhje me opinione, projekte dhe veprime; • të bëjë përshkrimin e qartë e të hollësishëm të një ecurie; • të krahasojë ose të vërë përballë alternativa, duke diskutuar se c'duhet bërë, ku duhet shkuar ose çfarë të zgjedhë; • të shprehë me mirësjellje pikëpamjen e tij dhe të ftojë të tjerët të shprehin pikëpamjet e tyre mbi një temë abstrakte ose kulturore, si: film, muzikë.
<p>Të shkruarit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 11 nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë tekste të lidhura thjeshtë mbi një gamë temash të ndryshme, duke lidhur një seri elementesh të dallueshme në një sekuencë lineare; • të bëjë përshkrime të hollësishme, të thjeshta, të drejtpërdrejta mbi një gamë të gjerë temash të njohura, në kuadrin e fushës së tij/saj të interesit; • të shkruajë një letër personale për të dhënë të rejat dhe të shprehë mendimin e tij mbi një temë abstrakte ose kulturore, si: film, muzikë etj.; • të shkruajë shënime dhe letra personale për të kërkuar ose transmetuar informacione dhe të bëjë të qarta pikat që i konsideron të rëndësishme; • të shkruajë shkurt e në vija të përgjithshme një kritikë filmi a libri; • të bëjë përmbledhjen e një përvoje, duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij, në një tekst të thjeshtë e koherent; • të shkruajë ese të thjeshta e të shkurtra mbi tema të interesit të përditshëm; • të përmbledhë me njëfarë sigurie një burim informacionesh faktike, mbi tema të njohura ose të

	<p>panjohura, të bëjë raportin për to dhe të japë mendimin e tij;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë raporte shumë të shkurtra në formë standarde që transmetojnë informacione faktike dhe justifikojnë veprime.
--	---

5. KËRKESA TË GJUHËS ANGLEZE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11^{të} integrohet me lëndët e tjera që nxënës/i,-ja zhvillon gjatë vitit shkollor, duke i shërbyer formimit më të plotë gjuhësor, intelektual dhe kulturor të nxënësve.

Fushat tematike të parashtruara për realizimin e objektivave në këtë program japin kontekste të ndryshme ku nxënës/i,-ja merr koncepte gjuhësore dhe i praktikon ato. Meqenëse njohja rreth botës është më e plotë, në këtë fazë të arsimimit bëhet e mundur që aftësitë shprehëse gjuhësore të rriten, duke thelluar kështu integrimin ndërlëndor.

Ndërthurja ndërlëndore shprehet si më poshtë:

1. Lidhja mes gjuhës angleze dhe *matematikës* shprehet në përdorimin e shifrave, të numrave dhe të veprimeve matematikore në gjuhën e huaj, si p.sh.: sistemi metrik evropian dhe anglez.
2. Lidhja e gjuhës së huaj me shkencat natyrore, p.sh.: me *biologjinë*, reflektohet në trajtimin e temave rreth trupit të njeriut, bimësinë, si dhe në ndikimin e funksioneve që ato kryejnë.
3. Në lëndën e TIK-ut, nxënës/i,-ja aftësohet të përdorë internetin, e-mailin, programe të ndryshme që e ndihmon atë të eksplorojë të rejtat mbi botën që ai/ajo studion.
4. Me *artet* janë të lidhura ngushtë temat rreth personaliteteve dhe kontributit të tyre në fushën e sportit, muzikës, modës dhe pikturës.
5. Me *shkencat sociale* janë të lidhura tema, si: miqësia, marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet në shkollë, marrëdhëniet në komunitet, koha e lirë dhe shfytëzimi i saj si pjesë e fushës tematike “Jeta shoqërore dhe presonale”.

Bashkërendimi ndërlëndor në programin e klasës së 11^{të} mundëson realizimin e synimeve dhe objektivave të përgjithshme të programit për:

edukimin intelektual. Gjatë njohurive që nxënës/i,-ja merr në këtë nivel shkollimi, ai/ajo fillon të analizojë, të sintetizojë dhe të vlerësojë, duke rritur cilësinë e nxënies dhe pavarësinë e tij të të nxënësve.

edukimin mjedisor. Temat rreth ndotjes dhe mjedisit paraqesin kontekste kuptimplote, ku shqetësimi dhe nevoja për zgjidhjen e problemeve shoqërohet me fjalor dhe struktura gramatikore më të ndërlikuara, duke forcuar aftësinë shprehëse gjuhësore për të krahasuar dhe analizuar shkaqet, pasojat dhe zgjidhjet.

edukimin kulturor dhe etik. Përmes lëndëve histori, gjeografi, letërsi e histori arti nxënës/it,-et fitojnë njohuri për vendet anglishtfolëse, kulturën, mënyrën e jetesës, doket e zakonet. Këtu përfshihen edhe shprehjet etike specifike të këtyre popujve, si pjesë të tyre kombëtare. Ky edukim e ndihmon nxënës/in,-en të reflektojë sisteme vlerash të ndryshme.

Përmes konteksteve ndërveprimi të ngjashme me ato reale nxënës/i,-ja mëson jo vetëm rreth këtyre kulturave, por edhe si të përshtatet me to. Kjo realizohet përmes funksioneve gjuhësore, si p.sh.: të kërkojë falje e sqarime, të shprehë keqardhje e gëzim, aprovim apo mosaprovimim etj.

edukimin për të drejtat e njeriut. Njohja e kulturave të vendeve anglishtfolëse arrihet nëpërmjet temave: të barazisë sociale, të diskriminimit social, të respektit reciprok, të barazisë gjinore si çështje themelore për një shoqëri moderne.

atdhedashurinë. Njohja dhe krahasimi i kulturave të vendeve anglishtfolëse dhe vendase, dallimi i veçorive dhe i të përbashkëtave ndërgegjësojnë nxënës/in,-en për identitetin kombëtar dhe kulturor.

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11^{te} është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e gjuhës angleze, si kurrikula e AML-së dhe standardet e fushës kurikulare, ku kjo lëndë bën pjesë. Ky program reflekton hapat që përdoruesit (p.sh.: mësuesit, instruktorët) ndërmarrin gjatë planifikimit të procesit të mësimdhënie/nxënies, si dhe vlerësimit.

Tipari kryesor i kurrikulës së AML-së është dhënia në formë spirale e kompetencave gjuhësore, që nënkupton përsëritjen dhe rimarrjen e tyre në veprimtari dhe kontekste gjuhësore gjithnjë e në rritje. Për këtë arsye, përdoruesve të këtij programi u duhet të njihen me programet lëndore të gjuhës angleze për klasat paraardhëse, si dhe nivelin gjuhësor A1, A2, B1, sipas Kuadrit Evropian të Referencave për Gjuhët.

Përderisa programi i gjuhës angleze për klasën e 11^{te} ndërthuret me programet e lëndëve të tjera, përdoruesve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

Zbatimi i programit realizohet nëpërmjet hartimit individual të planeve vjetore, semestrare dhe ditore, ku mësues/i,-ja ka liri veprimi në përputhje me nevojat e nxënësve.

A. Objektivat

Objektivat e parashtruara në programin e gjuhës angleze për klasën e 11^{te} janë të detyrueshme për t'u realizuar nga mësuesi dhe duhen përvetësuar nga nxënës/i,-ja. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Objektivat nuk janë të rënditura sipas shkallës së vështirësisë. Realizimi i objektivave në tema, kapituj e njësi mësimore dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Meqenëse niveli i nxënësve brenda klasës është i ndryshëm, atëherë mësues/i,-ja ka nevojë të bëjë punë të diferencuar me nxënësit e tij/saj. Kjo kërkon që përveç përcaktimit të objektivave të përgjithshëm të arritjeve, të përcaktojë objektivat për nxënësit e nivelit të ulët, të nivelit mesatar dhe të nivelit të lartë.

Shembulli më poshtë është thjesht për ilustrim:

Topic: Job hunting

Overall objective: By the end of the lesson the student should be able to:

- Read and comprehend the passage
- Find information and talk about the given topic;

Specific objectives: By the end of the lesson the student should be able to:

Minimum

- Identify vocabulary related to jobs, personal qualities;

Medium

- Get the overall idea of the reading passage;
- Practise the vocabulary related to jobs;
- Ask and answer questions about the topic;
- Identify paragraphs in a letter of application.

Maximum

- Discuss about the topic or interview somebody about it;
- Give advice, accept and refuse it;
- Read for specific information;
- Identify formal and informal style.

Grammar

By the end of the lesson the student should be able to:

Minimum

- Identify and underline the adjectives;

Medium

- Identify and practise the compound adjectives;

Maximum

- Write a letter of application using the proper adjectives.

B. Orët mësimore

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11^{të} është vazhdimësi e programit të klasës 10^{të}. Ai përmban objektiva dhe standarde sipas fushave, si dhe parashtron objektiva për çdo aftësi, që synon realizimin e standardeve të përcaktuara në program, për nxënësin dhe mësuesin.

Sasia e orëve mësimore është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara. Kjo do të thotë se mësues/i,-ja mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit e tij/saj hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij/saj demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së gjuhës angleze afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe **30%** e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

B.1. Shpërndarja e orëve mësimore (36 javë x 3 orë = 108 orë)

Gjuha angleze për klasën e 11^{të} zhvillohet me 3 orë mësimore në javë (36 javë x 3 orë = 108 orë vjetore) dhe shpërndarja e orëve të planifikuara është si vijon:

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në kapituj e njësi mësimore) aftësitë gjuhësore dhe linjat ndërthuren me njëra-tjetrën. Mësues/i,-ja është i/e lirë të bëjë kombinimin e tyre brenda një kapitulli ose një njësie mësimore, pavarësisht renditjes në tabelën e shpërndarjes së orëve.

Komunikimi dhe formimi kulturor zë 85 orë, të cilat ndahen, sipas objektivave që u përgjigjen, në 60 orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (*nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 42 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 18 orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive; me përpunim do të kuptojmë, p.sh.: përforcimin e informacionit të marrë në temat përkatëse ose ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni*) dhe 25 orë për aktet dhe funksionet e komunikimit (*nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 18 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30% e tyre, d.m.th. 7 orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Këtu mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës, d.m.th. ai jep detyra komplekse, ku pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas aftësive dhe objektivave në një kapitull.*).

Orët e përgjithshme për përpunimin e lëndës janë 31 orë, nga të cilat 5% e tyre, d.m.th. 6 orë, do të përdoren për përpunimin e të gjithë lëndës, ku vlerësimi tërësor i lëndës zë vendin e tij (p.sh.: 3 orë mund të përdoren për përsëritjen dhe 3 orë për vlerësimin me shkrim e me gojë të dijeve që kanë përfutur nxënësit gjatë procesit të nxënies).

Formimi gjuhësor zë 23 orë. Janë kryesisht orë në të cilat mësues/i,-ja shtjellon, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (*nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 16 orë mësimore, do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 7 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përforcimin e tyre*).

Përmbajtja mësimore e lëndës së gjuhës angleze për klasën e 11^{të}, si vijuese e nivelit A1 deri në B1+ në arsimin e ciklit 9-vjeçar dhe në AML realizohet, duke u orientuar në këtë fazë të arsimit të mesëm të lartë në nivelin B1.2.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen e njohurive bazë (konceptet themelore);
- testimin e njohurive bazë;
- integrimin e njohurive të reja të lëndës me njohuritë e fituara më parë;
- integrimin e aftësive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit u duhet kushtuar kohë e posaçme);

- përsëritjen vjetore;
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Gjatë përpunimit të njohurive duhet t'u kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- aftësive të përgjithshme, si: të komunikimit, të menazhimit të informacionit, të zgjidhjeve problemore dhe të të menduarit kritik e krijues;
- aftësive gjuhësore, të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit;
- formimit të qëndrimeve, si: qëndrimi etiko-social, qëndrimi gjatë punës në grupe të vogla nxënësish etj.

Në orët mësimore që i përkasin përpunimit të njohurive, mësues/i,-ja zhvillon edhe tema me nismën e tij/saj ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike e projekte kurikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

Programi i klasës së 11^{te} orienton gjithë procesin e mësimdhënies e të nxënies së gjuhës angleze në nivelin B1.2.

Metoda dhe strategji të mësimdhënies/nxënies.

Mësues/i,-a është i/e lirë të përdorë një larmi metodash e strategjish të mësimdhënies/ nxënies për t'ua përshtatur nevojave të nxënësve në klasa të ndryshme. Ai/aajo i kombinon këto metoda gjatë procesit mësimor dhe i përshtat ato në bazë të zhvillimit në rritje të kompetencave gjuhësore dhe të zhvillimit të pavarësisë së nxënës/it,-es në vijueshmëri të këtij procesi.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën e komunikimit, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe atë të situatave sa më afër jetës reale etj. Këto metoda realizohen nëpërmjet strategjive dhe teknikave të ndryshme, sipas aftësive gjuhësore (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit).

Në këtë nivel gjuhësor zbatohen të gjitha strategjitë për katër aftësitë gjuhësore, por ato përshkallëzohen nga niveli në nivel në varësi të objektivave.

Të dëgjuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të dëgjuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- të mbajë shënime gjatë dëgjimit;
- të klasifikojë çështjet që dëgjon;
- të përqendrohet e të zbulojë detaje specifike;
- të hamendësojë çfarë flitet në magnetofon;
- të arsyetojë mbi bazë të asaj që dëgjon;
- të përdorë njohuritë e tij/e saj të mëparshme;
- të bëjë lidhje mes asaj që dëgjon dhe materialit pamor;
- të dëgjojë një tregim, këngë etj. disa herë, për të kuptuar idenë kryesore, duke u përqëndruar në fjalët e rëndësishme, në rastin kur nuk kupton gjithçka;
- të përqendrohet te kërkesa e dëgjimit;
- të vërë qëllime dhe objektiva për zhvillimin e aftësisë së dëgjimit;

- të përpiqet që gjatë dëgjimit të kuptojë referencat kulturore, jo të njohura për të, duke përdorur kontekstin, për të hamendësuar kujt ato i referohen.

Të folurit

Për të zhvilluar aftësinë e të folurit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- t'i kërkojë folësit të përsërisë çfarë tha, në rast moskuptimi;
- të mos ndalojë plotësisht ligjërimin, kur nuk di një fjalë ose shprehje, por të përdorë shprehje e fjalë të njohura;
- të përdorë shprehje si: Mm, Ëell, Kind of, Sort of etj., me qëllim që të fitojë kohë për gjetjen e fjalës së duhur;
- të përsërisë një pjesë të asaj çka thotë bashkëfolësi, për të miratuar se biseda ndërmjet tyre po përcillet në mënyrë të drejtë kuptimore;
- të pyesë bashkëbiseduesin për të bërë të qartë atë që është thënë.

Të lexuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të lexuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- të kërkojë të dhëna që e ndihmojnë për të parashikuar përmbajtjen e tekstit, si: figura, titulli i mësimit, dy rreshtat e parë të mësimit;
- të lexojë tekstin për herë të dytë, që të nxjerrë kuptimin e fjalëve të panjohura;
- të lexojë pyetjet rreth tekstit dhe të mendojë për përgjigjet e mundshme;
- të gjejë përgjigjet e pyetjeve në tekst, duke përcaktuar paragrafin që u përket pyetjeve;
- të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin kryesor;
- të përdorë përshkrimin me fjalë të njohura, kur nuk di kuptimin e një fjale të dhënë;
- të përdorë fjalë të tilla si: Right, Absolutely, Exactly etj., për të treguar interes dhe vëmendje ndaj bashkëbiseduesit;
- të bëjë bisedë të ndërsjellë me bashkëbiseduesin;
- të mbajë shënime gjatë një bisede ose diskutimi, për të përmbledhur mendimin e tij.

Të shkruarit

Për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- të mbajë shënime për informacionin që i duhet të përfshijë në detyrën e caktuar;
- të planifikojë paragrafët, duke shkruar idenë kryesore të secilit paragraf;
- të plotësojë paragrafët me informacion mbështetës, si: shembuj, sqarime etj.;
- të kontrollojë lidhjen logjike të paragrafëve, duke përdorur lidhëzat përkatëse;
- të redaktojë shkrimin e tij ose të këmbejë punën e tij me atë të shokut.

C. Parime për zbatimin e programit

Zbatimi i programit mbështetet në parimet e mëposhtme:

Vendosja e nxënës/it,-es në qendër të vëmendjes

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11^{të} rrit njohuritë gjuhësore të nxënës/it,-es përmes temave që i përshtaten interesave dhe nevojave të tij/saj gjuhësore dhe shoqërore.

Objektivat që programi vendos janë të përshkallëzuara dhe i përshtaten aftësive moshore të tij/saj.

Strategjitë e parashikuara nxisin ndërveprimin gjuhësor dhe komunikativ, duke e përfshirë nxënës/in,-en edhe në organizimin e veprimtarive dhe përdorimin e teknikave që i përshtaten atij/asaj.

Krijimi i mjedisit të të nxënës

Shkolla dhe mësues/i,-ja krijojnë një ambient fizik, emocional dhe akademik, që mbështetin të nxënës bashkëkohor dhe rrisin efektshmërinë, duke krijuar një atmosferë sfiduese dhe konkurruese.

Krijimi i mjedisit të përshtatshëm të të nxënës lehtëson përdorimin e formave të bashkëpunimit në klasë, si p.sh.: punën në çifte apo në grupe.

Organizimi i klasës

Mësues/i,-ja kujdeset për aspektet organizative të mësimdhënie/nxënies. Për ta lehtësuar mësimdhënien/nxënien, ai/ajo gjen mënyra frytdhënëse gjatë organizimit të veprimtarive, të orës së mësim, sigurimit dhe sugjerimit të materialeve burimore për nxënësit etj.

Në mësimdhënien bashkëkohore mësues/i,-ja luan rolin e mbikëqyrësit. Gjatë përfshirjes së nxënës/it,-es në procesin e nxënies, mësues/i,-ja vendos një marrëdhënie bashkëpunimi, duke i qartësuar nxënësit dhe duke marrë mirëkuptimin e tyre për atë çfarë ndodh në klasë. Kjo nënkupton sqarimin e rregullave të radhës së punës dhe përgjegjësiive të nxënësve në procesin e kryerjes së veprimtarive.

Mësues/i,-ja sugjeron dhe siguron përdorimin e mjeteve audiovizuale, elektronike dhe ndihmon nxënës/in,-en në përdorimin e formave të ndryshme të teknologjisë informative brenda dhe jashtë klase.

Gjatë planifikimit dhe organizimit të veprimtarive, mësuesi ka në qendër të vëmendjes në këtë fazë të zhvillimit gjuhësor dhe formimit intelektual, nxitjen e mendimit kritik.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësues/i,-ja siguron ndërveprimin gjuhësor dhe bashkëpunimin mes nxënësve gjatë organizimit të veprimtarive në klasë. Ai/ajo përdor forma të larmishme që i përshtaten nivelit dhe veçorive individuale të nxënësve. Ato variojnë nga ndërveprimi në çift apo në grup, në debatin e hapur për gjithë klasën, ku mësues/i,-ja ndërhyr të nxisë pjesëmarrjen ose të monitorojë pyetjet e hapura me disa përgjigje të sakta. Këto forma i bëjnë nxënësit më bashkëveprues, më të pavarur në shprehjen e mendimit të tyre dhe respektimin ndaj ideve të të tjerëve. Gjithashtu, gjatë bashkëpunimit për kryerjen e detyrave në grup,

nxënësit mësohen të ndajnë dhe të mbajnë përgjegjësi për produktin e përbashkët. Ky kontekst nxit dhe zhvillon aftësitë gjuhësore në mënyrë të natyrshme duke përfituar nga njohuritë e të tjerëve, si dhe duke korrigjuar veten dhe të tjerët.

Përdorimi i gjuhës në klasë

Në këtë nivel gjuhësor, përdorimi i gjuhës angleze është një domosdoshmëri për përmirësimin e mëtejshëm të të gjithë aftësive gjuhësore, jo vetëm për kryerjen e veprimtarive gjuhësore, përthithjen e përmbajtjes, por edhe për dhënien e udhëzimeve. Mësues/i,-ja përdor gjuhën amtare për të shmangur keqkuptime, keqpërdorime dhe keqinterpretime të gjuhës angleze.

Të mësuarit e gramatikës

Komunikimi në gjuhë të huaj mbështetet në njohjen dhe përdorimin e njohurive gjuhësore, të cilat janë në nivelin B1.2 përdoren në kontekste më të ndërlikuara.

Njohuritë gjuhësore janë në shërbim të përfundimit të materialit të ri, ku trajtohen përmbajtja dhe veprimtaritë komunikuese në përdorimin e funksioneve gjuhësore që mësohen. Nëse deri në këtë nivel gjuhësor, përparësi i është dhënë rrjedhshmërisë në komunikim, në klasën e 11^{te}, tendenca shkon drejt saktësisë gjuhësore.

Qortimi i gabimeve

Megjithëse saktësia gjuhësore ka përparësi për të siguruar një komunikim të qartë në gjuhën angleze, qortimi i gabimeve bëhet me shumë kujdes, në mënyrë që të mos dekurajohen nxënësit gjatë shprehjes së tyre në gjuhën angleze.

Mësues/i,-ja ndërhyt vetëm atëherë kur praktikohen struktura gjuhësore të caktuara dhe më rrallë, kur nxënësit janë të përfshirë në debate dhe diskutime. Shpesh mësues/i,-ja dokumenton gabimet e përsëritura dhe, kur është e nevojshme, përshtat një sërë teknikash për shmangien e tyre.

Puna e diferencuar me nxënësit

Meqë niveli i aftësive gjuhësore të nxënësve është i ndryshëm në klasë, mësues/i,-ja ndërton punë të diferencuar për të arritur objektivat për klasën e 11^{te}. Për arsye të temperamenteve të ndryshëm psikologjik dhe të aftësive percptuese individuale të nxënësve, mësues/i,-ja përdor një larmi teknikash, metodash, strategjish apo forma vlerësimi për të lehtësuar përfundimin e gjuhës, si p.sh:

- të dëgjojë me kujdes nxënësit kur flasin dhe t'u japë përgjigje në kohën e duhur;
- të ndjekë ecurinë e çdo idividi duke mbajtur shënime përkatëse;
- të ndajë përgjegjësitë e nxënësve për veprimtaritë individuale apo në grup;
- të japë vazhdimisht përshkrime të punës së nxënësve;
- të kërkojë prej tyre vlerësime të punës së tij/saj, me qëllim që të reflektojë ndaj dobësive;
- të motivojë nxënësit në mënyrë të barabartë;

- të nxisë pjesëmarrjen e nxënësve indiferentë në punën në grup dhe të nxjerrë në pah punën e tyre në klasë.

7. VLERËSIMI

Zbatimi me rigorozitet i udhëzimeve për përdorimin e programit të klasës së 11^{të} bën të mundur vënien në praktikë të një mënyre vlerësimi bashkëkohore të dijeve të nxënës/it,-es, d.m.th. me bazë vlerësimin komunikativ me shkrim dhe me gojë gjatë gjithë procesit mësimor. Kjo metodë vlerësimi, mbështetur në Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët dhe në Portofolin Evropian për Gjuhët, jo vetëm përshkon gjithë procesin mësimor, por shërben edhe për përmirësimin e këtij procesi.

Kur vlerësimi mbështetet në aktivitetet e organizuara në klasë, të parashikuara në program, në përputhje me objektivat e tij, ai siguron:

- një matje të rregullt të ecurisë së nxënës/it,-es në gjuhën angleze;
- një informacion për rivlerësim të përmbajtjes lëndore, si dhe cakton detyrat për të ardhmen;
- një përmirësim të njohurive të nxënës/it,-es;
- një përgjegjshmëri të të gjithë pjesëmarrësve në procesin e mësimdhënies/nxënies (nxënës, mësues të gjuhës angleze dhe ndërlëndorë, drejtorja e shkollës, inspektori i arsimit për gjuhën angleze dhe detyrimisht edhe prindërit).

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënës/in,-en për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë sa më objektiv dhe i matshëm. Asgjë nuk është më nxitës, sesa sukcesi i arritur duke u përballur me gjendjen reale në të cilën ndodhet një nxënës/e. Mësues/i,-ja monitoron dhe vlerëson detyrat, duke përcaktuar objektiva të qartë. Mësues/i,-ja përdor vetë dhe ndihmon edhe nxënësit që të përdorin një larmi mënyrash vlerësimi.

Vlerësimi mund të organizohet në disa forma:

Vlerësimi i dijeve (ose i niveleve), ku përfshihet vlerësimi i objektivave specifike. Ky vlerësim ka lidhje me atë çka është mësuar gjatë një jave, muaji ose semestri, pra me punën që është bërë me tekstin dhe programin. Vlerësimi i dijës është i bazuar në orën e mësimit. Kështu, ai i përgjigjet një vështrimi të brendshëm. Ky lloj vlerësimi është pozitiv për faktin se është më afër përvojës së nxënës/it,-es

Vlerësimi i kapaciteteve (ose i zbatimit të aftësive, ose i performancës) që është vlerësimi i asaj çka nxënësit mund të bëjnë ose dinë në raport me zbatimin e saj në jetën e përditshme dhe i lejon çdonjërit të pozicionohet aty ku e meriton, pasi rezultatet janë mëse të dukshme.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij/saj me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: vallëzon, eksperimenton, prodhon një maket etj.

Vlerësimi me shkrim dhe me gojë klasifikohet në:

Vlerësim formues, me anë të të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënës/i,-ja në formimin e tij/saj gjuhësor, në përputhje me objektivat e caktuar.

Vlerësim diagnostikues, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme, për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe përvetësimit të materialit gjuhësor të dhënë më parë. Gjithashtu, ai jep informacion për efektivitetin e të nxënësit dhe ndihmon në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies/nxënies.

Vlerësim i planifikuar mbi bazën e realizimit të objektivave të nënlinjave, pra në bazë kapitulli. Ky vlerësim bëhet me notë dhe realizohet në fund të çdo mësimi përsëritës.

Vlerësim motivues, ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënës/it,-es për mësimin e gjuhës angleze. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor. Mësues/i,-ja realizon këtë lloj vlerësimi duke gjetur shprehjet e duhura motivuese, si p.sh.: *mirë, shumë mirë* etj., dhe duke përdorur materiale që nxisin vlerësimin motivues të nxënësit, p.sh.: përgatitja e dosjes së arritjeve të nxënës/it,-es si pjesë e portofolit evropian të gjuhëve, ku ai vendos çertifikata, provime, projekte, dëshmi etj. që provojnë ecuri të tij në gjuhë.

Vlerësimi me notë

Vlerësimi i nxënës/it,-es bëhet me notë sipas sistemit të vlerësimit të vendosur nga MASH-i dhe AVA. Ky vlerësim nuk përfundon me vendosjen e notës. Ai përqëndrohet tërësisht në monitorimin dhe vlerësimin e njohurive të nxënësve të përfutuara në vazhdimësi, si dhe të rezultateve të arritura gjatë procesit të mësimdhënies/nxënies.

Mësues/i,-ja vlerëson nxënës/in,-en me notë gjatë vitit shkollor, ndërsa ai/ajo demonstroi zotërimin e njohurive dhe aftësive, si dhe qëndrimet të cilat janë parashikuar të kurrikula e gjimnazit dhe programet e lëndëve ose të moduleve. Lëndët e kurrikulës bërthamë dhe të asaj me zgjedhje, modulet lëndore dhe ato profesionale, projektet kurrikulare shkollore, pra, të gjitha veprimtaritë e të nxënësit për të cilat formulohen paraprakisht objektivat e të nxënësit, vlerësohen me notë.

Në punimet e nxënësve në grupe të vogla, është mësuesi që paracakton peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe atë të secilit nxënës në veçanti.

Vlerësimi përfundimtar

Në përfundim të semestrit të parë, për çdo nxënës/e dhe lëndë përllogaritet nota semestrale dhe në përfundim të vitit shkollor, nota vjetore. Nota e semestrit të parë dhe ajo vjetore përllogariten duke pasur si të dhëna fillestare të gjitha notat e nxënës/it,-es të shënuara në regjistër. Notat gjatë vitit shkollor nuk kanë të njëjtën peshë në njehsimin e notës semestrale dhe asaj vjetore. Peshat e një note përcaktohet nga lloji i saj.

Janë katër lloje:

- vlerësimet e përditshme,
- provimet periodike me shkrim,
- punimet e nxënësve,

- provimi përfundimtar (nëse mësuesi e zhvillon edhe këtë),

Duhet treguar kujdes që:

- Para testimit duhet bërë një model, që t'u tregohet nxënësve se si do të bëhet testimi.
- Caktohen më parë qëllimet e testimit për të kaluar më pas në zhvillimin e tij.
- Vlerësimi mund të jetë individual ose në grup.
- Në rastet kur testet hartohen me pyetje të llojeve të ndryshme, ato grupohen sipas llojit të tyre p.sh.: pyetje me zgjedhje të shumëfishtë bashkë, ato me çiftim bashkë e kështu me radhë.
- Është mirë që pyetjet në test të renditen sipas shkallës së vështirësisë së tyre. Zakonisht në një test, (p.sh.: në fund të një kapitulli) kërkohen që 40% të pyetjeve të jenë të nivelit të parë, 40% të nivelit të dytë dhe 20% të nivelit të tretë. Numri i pyetjeve në test varet nga ajo çka duhet testuar (një mësim, kapitull apo një koncept.)

Disa udhëzime për vlerësimin.

Është e domosdoshme që mësues/i,-ja të mos përdorë vetëm një formë vlerësimi, por larmi formash. Ato duhet t'u krijojnë nxënësve mundësi të vlerësohen në atë mënyrë që është e përshtatshme për çdo individ. Kështu, p.sh.: një nxënës/e përgjigjet më mirë me gojë, një tjetër me shkrim, njeri i shpreh bukur dhe me emocion mendimet në një pyetje të hapur, një tjetër jo dhe e ka të lehtë në pyetjet e mbyllura etj.

Vlerësimet e përfundimeve të nxënësve të trajtohen me kompetencë e jo si mesatare aritmetike e notave të vlerësimit formues.

Të kihet parasysh që përparimi i nxënës/it,-es dhe një gjykim përmbledhës në përfundim të periudhës bazuar në objektiva, përbën vlerësimin përfundimtar. Vonesat e dhënies së përfundimeve të vlerësimit dhe analiza e tyre nga mësues/i,-ja e ulin shumë vlerën e korrigjimit të gabimeve.

Shënime të jenë të thjeshta, por të pasura. Është e domosdoshme që përveç regjistrit të klasës, mësues/i,-ja të mbajë shënime të tjera për punën e çdo nxënës/i,-e. Ato ndihmojnë në njohjen dhe në vlerësimin e arritjeve, në diagnostimin e në riparimin e vështirësive dhe lehtësojnë vlerësimet përmbledhëse.

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi në lëndën e gjuhës se huaj do të fokusohet në aftësinë e zotërimit të koncepteve kyç të gjuhës se huaj dhe të aplikimit të këtyre koncepteve. Vlerësimi i aftësive do të vërë theksin në sjelljen e nxënësve në një punim të caktuar, sjelljen në grup dhe aftësinë e tyre për të përdorur burime të ndryshme për marrjen e informacionit në gjuhë të huaj si dhe vlerësimin në mënyrë kritike të këtij informacioni.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike e sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë si dhe ndihmon nxënësit dhe së bashku zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Metodat e vlerësimit të përdorura në gjuhë të huaj do të përfshijnë:

- teste me shkrim për të kontrolluar arritjet e nxënësve në lidhje me objektivat e programit,
- monitorimin e punës në grup të nxënësve,
- punët eksperimentale, raportet e punës,
- projektet, prezantimet e kërkimeve.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore.

Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të materialeve mësimore të zhvilluara në klasë dhe kryerjes së detyrave jashtë klase. Herë pas here, mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve, që në fillim, qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e nxënësve në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike. Mësues/i,-ja vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të zhvilluara vetë ose në grup. Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një apo disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhura të nxënit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai/ajo përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet disa minutëshe për një objektiv të veçantë të nxënit, tek ato njëorëshe. Planifikohen teste me alternativa ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Vlerësimi në gjuhë të huaj do të fokusohet në aftësitë e nxënësve në lidhje me të kuptuarit dhe përdorimin e këtyre njohurive.

Portofoli i nxënës/it.-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor për lëndën. Portofoli i nxënës/it.-es mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënës/i,-ja, ndërsa mësues/i,-ja rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh.: të nxënësve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësues/i,-ja, duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, përjashtuar vlerësimin me shkrim apo me gojë.

Vlerësim përfundimtar, që është vlerësim me notë e që finalizon arritjet e objektivave të linjave dhe të nënlinjave për këtë grup-moshë.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve dhe vendosjen e notave në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe

mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimit të njohurive të fituara nga orët e kaluara dhe rreth mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim, qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të realizuara vetë ose në grup.

Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, mësues/i,-ja përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pakminutëshe për një objektivi të veçantë të të nxënësve, deri tek ato njëorëshe; teste me alternativa ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurikulare etj. Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësiti është dhe provimi përfundimtar.

Vetëvlerësimi:

Vetëvlerësimi është një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës angleze, ku secili jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një plotësues i domosdoshëm i vlerësimit nga mësues/i,-ja dhe nga provimet, madje dhe nga prindërit e institucione të tjera vlerësuese. Vetëvlerësimi ka efekt kur:

- u referohet normave dhe kapacitetit që korniza e gjuhëve parashtron për grupmoshën e tyre,
- është i lidhur me një përvojë të veçantë, që mund të jetë ajo e kalimit të testeve.

Vënira e synimeve të qarta në program, mundëson vetëvlerësimin e tyre në vazhdimësi. Si mjet në vlerësim dhe vetëvlerësim shërben Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ), që me anë të tri pjesëve të tij: Pasaportës Gjuhësore, Biografisë gjuhësore dhe Dosjes, nxësin nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetëvlerësuar njohuritë e marra, dhe dokumentimin e arritjeve të tij gjuhësore të cilat mund të jenë: provime me shkrim, detyra tematike, çertifikata, projekte kurikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurikulare.

PEGJ-i është dokumenti që çdo nxënës që mëson një gjuhë ose ka mësuar një gjuhë, i cili është në shkollë ose jashtë saj, mund të shënojë njohuritë e tij gjuhësore dhe eksperiencat kulturore. PEGJ-i nxit çdo nxënës të mësojë më shumë gjuhë, edhe në nivele modeste dhe të vazhdojë t'i mësojë ato gjatë gjithë jetës. PEGJ-i nxit nxënësin të përmirësojë mësimin dhe kapacitetin e vlerësimit të aftësive të tij në fushën e gjuhëve. Përdorimi i PEGJ-it favorizon lëvizjen në Evropë duke informuar aftësitë për gjuhët në mënyrë të qartë dhe të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. PEGJ-i kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Evropë nëpërmjet eksperiencës së kulturave të tjera dhe me ndihmën e kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas mësues/i,-ja dhe nxënësit bëjnë komentimin përfundimtar.

Nxënësit, gjithashtu, vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit.

Nxënës/i,-ja mban shënim arritjet e tij/saj, duke përdorur edhe gjuhën amtare.

Mësues/i,-ja bisedon me nxënës/in,-en individualisht dhe i tregon arritjet.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimit; ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu, të organizojnë më mirë të nxënëset e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënës/i,-ja, ashtu edhe mësues/i,-ja.